

Intervista e Forumit Shqiptar me Dr. Robert Elsie

Në vazhdim të ciklit "Intervista e Forumit Shqiptar me..." sot mund të lexoni intervistën ekskluzive dhënë nga Dr. Robert Elsie (Albanolog Kanadez) për vizitorët e Albasoul.

*Intervista u përgatit dhe u mundësua nga Ylli Stefanllari.

Albanologu Robert Elsie lindi në Vankuvër (Vancouver) të Kanadasë më 29 qershor 1950. Ndoqi Universitetin e Kolumbisë Britanike (University of British Columbia), ku mbaroi studimet e filologjisë klasike dhe të gjuhësisë më 1972. Po në atë vit, erdhi në Evropë me një bursë studimesh. Vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Lirë të Berlinit Perëndimor (Freie Universität Berlin), në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta (Ecole Pratique des Hautes Etudes) në Paris, në Institutin e Dublinit për Studime të Larta (Dublin Institute for Advanced Studies) në Irlandë, dhe në Universitetin e Bonit (Universität Bonn), ku mbrojti doktoraturën më 1978. Që nga 1978 pati mundësi të vizitojë Shqipërinë disa herë në kuadrin e 'takimeve shkencore' midis Institutit të Gjuhësisë së Universitetit të Bonit dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Gjithashtu mori pjesë disa vite me radhë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Kosovë. Pas studimeve universitare ai punoi për Ministrinë e Punëve të Jashtme gjermane në Bon. Është anëtar i Shoqatës së Evropës Juglindore (Südosteuropa_Gesellschaft), anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Jeton në një fshat malor të Gjermanisë afër kufirit belg.

F. Sh. Ju falenderoj për përgjigjen ndaj kësaj interviste në distancë dhe për urimet tuaja përfaqjen e ForumitShqiptar. Mbas kontaktit tuaj të parë me gjuhën shqipe cila ishte puna e parë në fushën e albanologjisë dhe përkthimi i parë letrar?

R.E. Unë fillova me poezinë shqiptare duke qenë se ajo ishte e panjohur në botën e jashtme. Duhet të keni parasysh se në vitet '80, bota dinte po kaq shumë për letërsinë shqiptare sa dimë sot, apo të paktën sa di unë sot, për letërsinë e Koresë së Veriut.

Së pari, hartova dy antologji të poezisë shqiptare, një vëllim gjermanisht *Einem Adler gleich: Anthologie albanischer Lyrik vom 16. Jahrhundert bis zur Gegenwart* (Si një shqiponje: antologjia e lirikës shqiptare që prej shekullit 16 deri me sot) botuar në vitin 1988, dhe një vëllim anglisht, *Anthology of Modern Albanian Poetry: an Elusive Eagle Soars* (Antologjia e poezisë moderne shqiptare: një shqiponje e arratisur fluturon) botuar me vonesë në vitin 1993. Kisha përkthyer edhe tërë veprën poetike të Migjenit (nuk ishte shumë), botuar gjermanisht në vitin 1987 dhe anglisht në vitin 1991. Përveç kësaj, botova në ShBA një fjalor të letërsisë shqiptare anglisht, *Dictionary of Albanian Literature* (1986) për të përhapur njohuri baze për këtë letërsi. Problemi im kryesor që prej fillimit dhe deri me sot nuk ka qenë hartimi i përkthimeve dhe i librave, por gjetja e një shtëpie botuese gati të botojë librat. Kuptohet që përkthime të letërsisë shqiptare nuk janë me fitim financiar as për mua as për botuesin.

F. Sh. Për mbi 20 vjet keni dhjetra e dhjetra studime, artikuj, reçenisonë, përkthime, etj. Cilat nga punët tuaja do të veçonit si arritjet më të spikatura dhe për cilat keni mëdyshjen apo dyzimin për ta riparë?

R.E. Mua më pëlqejnë gjithmonë librat e fundit, kurse me kalimin e kohës librat e para humbasin vlerën e tyre për të pasqyruar dhe të përhapur kulturën shqiptare në botë. Për

shembull, History of Albanian Literature (1995) dhe përkthimi i tij shqip Histori e letërsisë shqiptare (1997), do ti kisha bërë ndryshe sot. Mund të ju njoftoj se kam gati një botim të ri anglisht, i cili ka të ngjarë të quhet Introduction to Albanian Literature (Hyrje në letërsinë shqiptare), por deri me sot nuk kam gjetur një shtëpi botuese në Amerikë e cila e pranon. Gjithmonë i njëjti problem: kultura e vogël, e panjohur, dhe mungesa e fitimit financiar për botuesin.

F. Sh. *A mund të na tregoni disa hollësi rreth librave tuaj më të fundit të botuar, dhe të atyre që keni ende në punim e sipër?*

R.E. Gjatë këtyre dy viteve të fundit kam botuar mjaft. Në vitin 2003 dolën: përkthimi anglisht i veprës letrare të poetit Eqrem Basha: Neither a Wound nor a Song: Poetry from Kosova (As plagë as këngë: poezi nga Kosova); Behind Stone Walls (Prapa mureve të ngurta), monografi e etnologes norvegjeze Beritë Baker; një antologji tekstesh historike: Early Albania: a Reader of Historical Texts, 11th_17th centuries (Shqipëria e hershme: një doracak tekstesh historike, shek. 11_17); si dhe përkthimi anglisht i pesë këngëve të para të Lahutës së Malcis së Fishtës (The Highland Lute: the Albanian National Epic, Cantos I_V, The Cycle of Oso Kuka (Lahuta e Malcis: epika kombëtare shqiptare, këngët I_V, cikli i Oso Kukës).

Në fillimin e vitit 2004, dolën edhe dy vepra kryesore në ShBA: Historical Dictionary of Albania (Fjalori Historik i Shqipërisë) me më shumë se 700 zëra; dhe, në bashkëpunim me Janice Mathie_Heck nga Kalgari (Calgary) në Kanada, Songs of the Frontier Warriors: Albanian Epic Verse in a Bilingual English_Albanian Edition (Këngë Kreshnikësh: poezia epike shqiptare në një botim dygjuhësor shqip_anglisht). Të dhëna për gjithë këto botime dhe për botime të tjera të mia mund të lexoni në faqjen time të internetit: www.elsie.de.

Në punim e sipër, si projekt afatgjatë, e kam që prej vitesh përkthimin anglisht të Lahutës së Malcis tërësisht (një çmenduri nga ana imel!). Përveç kësaj, i kam gati një fjalor historik për Kosovën, një antologji tregimesh shqiptare anglisht (e cila pret botimin e saj në Çikago), dhe vëllime të veçanta të përkthimit anglisht të poetëve Azem Shkreli dhe Visar Zhiti.

F. Sh. *Poezia e për më tepër epika në botë nuk ka treg, shtoi dhe faktin që kjo vjen nga një vend i vogël, si ja dolët mbanë me Këngë Kreshnikësh, dhe si e mendoni ta arrini me Lahutën e Malësisë?*

R.E. Për Këngët e Kreshnikëve arrita për fat të interesoj një botues, Bolchazi_Carducci, në Illinois. Kjo shtëpi botuese, slovake, ka botuar mjaft letërsi epike. Botuesi vetë, Zoti Lou Bolchazy, kishte studiuar pranë profesorit Berkeley Peabody_t, i cili vetë kishte qenë student i Albert Lord_it në Harvard. Lordi, bashkë me Milman Parry, shquhen në botën perëndimore si zbuluesë të epikës ballkanase. Lordi kishte kryer hulumtime etnografike edhe në Shqipëri në vitin 1937. Figurat e tyre u përfytyruan në librin e Ismail Kadaresë, Dosja H. Pra, ka një vazhdimësi të çuditshme deri tek unë, gjë që nuk e dija në fillim të procesit botimor.

F. Sh. *Cila ka qënë ndihma konkrete që ju ka dhënë shteti shqiptar dhe organizmat e varura prej tij në këtë promovim të pandalshëm të kulturës shqiptare? Po nga Presidentët tanë a ju janë dhënë urdhra a medalje? Raporti juaj me Akademinë e Shkencave dhe Universitet, (theksoj Universitetin e Tiranës) cili është?*

R.E. Nuk them se shteti shqiptar më ka dhënë ndonjë ndihmë konkrete koha e fundit, por as

nuk i kam kërkuar ndonjë ndihmë të veçantë. Nuk ankohe. Kam marrëdhënie të mirë profesionale dhe miqësore me shumë shkencëtarë shqiptarë nga Akademia dhe nga Universiteti i Tiranës, njerëz që punojnë në kushte shumë të vështira. Për sa i përket urdhrave dhe medaljeve, unë nuk kam shumë dëshirë të bëhem një personalitet publik.

F. Sh. *Si një ndër përkthyesit e pakët nga shqipja në anglisht, sa prej letërsisë veçanërisht poezisë që botohet sot ju bie në dorë? Ç' mendim keni për këto krijime dhe autorët e tyre?*

R.E. Në vitet '90 udhëtoja rregullisht në Shqipëri, gati çdo dy muaj, dhe bleja gati tërë librat që më duheshin. Gjatë pesë viteve të fundit, ku më rrallë shkoj në Shqipëri, them se nuk arrij të gjej tërë librat që më duhen, veçanërisht sepse vëllimet më të mira poetike shpesh nuk gjenden në libraritë ku kërkoj. Shpërndahen privatisht.

Kuptohet që nuk mund të jap një mendim të saktë për krijimtarinë letrare në Shqipëri sot, por them se dy tre vite të fundit kanë qenë më interesante se vitet '90, ku kishte shumë eksperimentime kot dhe kopijime të letërsisë së huaj. Kam përshtypjen të pakten që ka lëvizje tani në fushën e poezisë.

F. Sh. *A do të kemi prej jush përkthime të tjera të poezisë bashkëkohore, nëse po, nëpër cilët rrugë a filtra do kalojnë këto krijime? Nëse po, do të zgjidhni midis fituesve në çmimet e konkurseve letrare, apo do preferoni një përzgjedhjen tuaj?*

R.E. Besoj se do të vazhdoj herë pas here të përkthej letërsi, nëse kam kohë dhe nëse arrij të gjej një botues. Kjo është pengesa kryesore për mua. Kot të përkthesh nëse përkthimet nuk botohen. Pikërisht për këtë arsye, them nga dëshpërimi, i futa gati tërë përkthimet e mia letrare në internet, në faqjen time të dytë: www.albanianliterature.com sepse përndryshe kot janë në kompjuterin tim.

Përsa i përket përzgjedhjes, them se nuk kam një strategji të veçantë. Disa vepra i përkthej sepse më pëlqejnë personalisht, apo autorët e tyre më pëlqejnë si individë, por zakonisht pyes shumë, marr mendime të ndryshme dhe në fund bëj një sintezë. Natyrisht e kam të qartë se një filan autori shahet tmerrësisht nga konkurenti i tij dhe lavdërohet jashtë mase nga kushëri i tij i dytë. Në Ballkan duhet të kesh këto gjëra parasysh. Duke qenë se letërsia shqiptare njihet pak, është e arsyeshme parimisht që të përkthehen fillimisht autorë më të njohur në Shqipëri dhe në Kosovë, por kjo nuk duhet të përjashtojë aspak autorë të rinj.

F. Sh. *E kemi të lehtë të ngrejmë panteonin e krijuesve shqiptarë ndër vite, por të vështirë një panteon krijimesh, vlerat dhe bukuria e të cilave të dalin fitimtare mbi kohën. Cilat do të ishin disa prej veprave më të spikatura të letërsisë shqiptare?*

R.E. Kjo është në fakt një pyetje e vështirë. Përveç Kadaresë, nuk shoh se kush do të rrijë në panteonin e letërsisë shqiptare pas 20 viteve, por kam përshtypje se do të ketë shumë figura që nuk i njohim sot. Pas tronditjeve të rënda politike, ekonomike por edhe kulturore të 15 viteve të fundit, Shqipëria ngadalë ngadalë po merr vetën, në mënyrën e saj, dhe jam i bindur se do të ketë autorë me shumë talent (por ndoshta shumica do të jenë në emigracion). Në fund të fundit, është lexuesi shqiptar, dhe jo unë, i cili do të vendosë, apo të themi më realisht, i cili duhet të vendosë për pranimin afatgjatë apo mospranimin e autorëve të kësaj letërsie.

F. Sh. *Vështirë të mendohet një përkthyes poezie të mos shkruajë dhe vetë. A keni krijime të tilla dhe a mendoni tja jepni në shqip publikut mbase nëpërmjet një botuesi shqiptar?*

R.E. Të zhvishem krejt para jush? Jo, jo...

F. Sh. *Përkthyes dhe interpret në Hagë në gjyqin ndaj Millosheviçit, dhe njohës i përmasës së dhimbjes në vargjet e poetëve shqiptarë të Kosovës. A pati raste të bënit një lidhje të tillë shkak pasojë?*

R.E. Them përgjithësisht se vuajtja nxit frymëzimin dhe krijimtarinë letrare. Çfarë ka prodhuar një vend si Zvicra, e cila nuk ka njohur dhimbje apo tronditje? Orë me qyqe dhe çokollate. Por ndonjë autor botëror? Nuk ka vend tjetër në Evropë i cili ka vuajtur më shumë së Kosova gjatë 15 viteve të fundit. Kështu unë pres gjëra të mëdha prej asaj. Në anën tjetër habitem nga pak se deri tani nuk ka dalë prej Kosovës një vepër madhore për atë që ky popull ka pësuar.

F. Sh. *Një veprimtari në albanologji me sa duket e lidhur pazgjithshmërisht. A e keni menduar ti dhuroni Arkivit të Shtetit Shqiptar, dorëshkrimet, shënimet origjinale etj si këto?*

R.E. Nuk besoj se jam kaq i rëndësishëm sa që shënimet e mia të mblidhen në Arkivin e Shtetit. Më interesant në rastin tim do të jetë ndonjë ditë biblioteka ime. Kam përshtypjen se kam një ndër bibliotekat kryesore albanologjike në botën perëndimore, ndoshta koleksionin më të madh të letërsisë shqiptare jashtë Ballkanit. Por biblioteka ime është një problem për të ardhmen. Akoma e shfrytëzoj.

F. Sh. *Me bindjen se e keni skalitur emrin tek miqtë e vyer të shqiptarëve, apo jeni një shqiptar pa pashaportë, çfarë do ti thoshit popullit gjuhën e të cilit e flisni si bir i tij?*

R.E. Nuk besoj se mund të bëhem shqiptarë tërësisht. Unë veç i vëzhgoj shqiptarët nga largët, me dashamirësi por edhe me shumë kritikë. Një fjalë popullit shqiptar? Kam një urim të dyfishtë. Unë uroj që shqiptarët të ruajnë identitetin e tyre kulturor në botë (pra elementet fisnike dhe pozitive të kësaj kulture), por, njëkohësisht, uroj që shqiptarët të lenë mënjanë mendjengushtësinë, nacionalizmin dhe etnozentrizmin e tyre dhe që ata të bëhen evropianë dhe qytetarë të botës.

[Botuar në faqen e internetit *Forumi Shqiptar*: www.forumishqiptar.com dhe në www.albasoul.com më 09 shkurt 2004 / Published on the website of *Forumi Shqiptar*: www.forumishqiptar.com and on www.albasoul.com on 09 February 2004]